



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr 340/2 Prot

Elbasan më, 25.05.2023

Lënda: Njoftim për vend të lire.

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”.

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

- Kujdestar Social (1) person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vëpruar;
- b) Të jetë në kushtë shëndetësorë që e lejojnë të kryesj detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- e) Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës ne grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplome nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim personal pas të mesëm në profesionin e kursit që aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar.
- c) Të njohë dhe të përdor teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire , duhet të përfshijë.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e identitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim i gjendjes shëndetësore
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës 05.06.2023.

DREJTOR

KRENAR XHEMALI

